

GLLOGOC MUNICIPALITY

PRANUAR

19/08/2024

| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
|----------|-------|---------|-------|
|----------|-------|---------|-------|

| | | | |
|----|--------------|--|--|
| 01 | 060104-40065 | | |
|----|--------------|--|--|



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Opština Drenas –Municipality of Drenas

Zyra e Kryetarit



Nga/Od/From:

Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2025-2027

Për/Za/To:

Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit

P R O C E S V E R B A L

i dëgjimit buxhetor:

Datë: 30.07.2024

Ora: 13:30

Vendi : Arllat

Dëgjimi publik në Arllat, Llapushnik, Gjergjicë, Negroc dhe Vuqak për buxhetin e vitit 2025-2027, të mbajtur me datë 30.07.2024, e hapi Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informim.

Kryetari Ramiz Lladrovci mbajti një fjalë rasti ku falenderoj të pranishmit për bashkepunimin në të mirë të qytetarëve.



Pyetjet, sugjerimet dhe komentet e parashtruara:

Shumzim Bujupi, Administrator i Arllatit: të funksionalizohet qerdhja e fëmijëve . Puntori teknik nga ambullanta është hjek. Poashtu edhe analizat janë hjek nga kjo AMF. Ndriqim në lagjen e xhamisë, te Faniqt dhe Bytyqt. Poashtu edhe Gjergjica është pa ndriqim. Kemi problem me mbyllja të kanalizimit, brenda mundësive të ndrrohen gypat dhe kanalizimi të lidhet me kolektor. Te lagija Faniqi të ndërtohet gropë sepike sepse kanalizimi del ne ara. Te Bytyqt të ndrrohet gypi i kanalizimit. Rruga te lagija e xhamisë ka mbetë në gjysmë.

Hysni Bujupi, Kemi problem me kanalizim i cili është ndërtuar keq dhe gypat janë joadekuat. Ujërat e zeza ma kanë infektu bunarin.

Burim Gashi, katër rrugë janë me ndriqim të pjesshëm, rotuar rreth 1 km, të bëhet renovimi i rrugës sepse është prish nga kamionat, kanalizim rreth 800 m, rrethojat pë dy palë varreza.

Xhevdet Krasniqi, përfaqësues i Negrocit dhe Vuqakut, te asflatojen rrugë Haki Krasniqi dhe Plumbat e lirisë. Ndriqimi dhe kanalizimi janë kryer rreth 90% dhe të vazhdohet pjesa tjetër. Të hapet kanali kullues ne rrugë Begzat Krasniqi. Ti hapet dera fushës sportive në oborr të shkollës.

Blerim Gashi, përfaqësues i lagjes Faniqi, lagja jone është pa ndriqim dhe kanalizim. Të vendoset gropë sepike te ura. Shtyllat e rrymës janë të vjetruara. Poashtu kërkojmë trotuar nga lagja jonë deri te shkolla.

Dervish Bytyqi, përfaqësues i lagjes Bytyqi, duhet të vlerësojmë ato projekte të cilat janë kry. Në secilen lagje është kryer ndonjë projekt. Përkundër kësaj është e natyrshme qe ka edhe kërkesa të reja për investime. Kërkojmë trotuar rreth 1200m, ndriqimi të vazhdohet aty ku ka mbetur pa përfundu. Ujësjellësin si lagje e kemi ndërtu vetë dhe e kemi shkatërru vetë me kyqje ilegale. Kërkojmë që të na ndihmoni me ja ndryshu gypit kahjen(600 m gyp).

Valentina Leku- Gashi, kërkojmë rrethojë të shkollës dhe këndë të lojrave.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci pati përgjigje dhe komente në të gjitha çështjet e parashtruara nga të pranishmit ku theksoj se trotuarët dhe rrugët do të shtrohen aty ku prona është publike ose prona private i dhurohet komunës dhe kalon në pronësi të saj, ndriqimi do të vazhdoj gjatë këtij viti aty ku ka shtylla betoni sepse tash jemi në procedurë të lidhjes së kontratës së re. Qerdhja është duke u funksionalizuar. Salla e sportit është bërë dhe objekti i vjetër i shkollës është rrrenuar me kërkësë të qytetarëve. Analizat nga AMF janë larguar në bazë të Rregullores e cila nuk lejon me u kry këto shërbime në AMF. QMF në Komoran është 24 orë



funkSIONALE. Sa i përkET PUNTORIT TEKNIK, TASHMË KOMUNA KA KONTRATË ME KOMPANI PËR MIRËMBAJTJA TË OBJekteVE.

Fusha sportive do të bëhet e poashtu fusha sportive e shkollës do të bëhet me bari artificial dhe mund të shfrytëzohet nga qytetarët pas mbarimit të orarit të mesimit. Problemi kryesor mbetet KUR Prishtina e cila nuk ka marr në pronësi investimet të cilat janë bërë ne rrjet te furnizimit me ujë dhe nuk është e interesuar të mirëmbajë pronat dhe as të furnizoj qytetarët me ujë. Është duke diskriminuar qytetarët e komunës sonë dhe për këtë gjë unë do të marr të gjitha veprimet e nevojshme.

Aty ku ka prishje të gypave të kanalizimit është kompania e kontraktuar nga komuna për mirëmbajtje e cila do të intervenoj. Poashtu gjatë instalimit të rrjetit të kanalizimi ju lutem mos pengoni sepse për këtë arsyе dalin ujërat e zeza jashtë dhe ju infektojnë.

Ruga e cila ka mbetë në gjysmë për arsyë se Operatori Ekonomik është terhjek nga kontrata për shkak të inflacionit.

Gjatë vitit 2025 do te kryhet rruga Pëllumbat e Lirisë se bashku me trotuar dhe ndriqim.

Sa u perket shtyllave, KEDS-i ka lyp leje dhe nuk ia kam aprovuar projektin sepse kam kerkuar që të vendoset rrjeti i energjisë elektrike skaj rrugës në mënyrë që të intervenohet me lehtë.

Për ujësjellës do të mundohemi me rrit kapacitetin për me u furnizu komplet lagjja dhe mos me pas telashe.

Muhamed Gjoka, Drejtore i DKA, rrethoja e shkollës është në procedurë të prokurimit dhe gjatë këtij viti do të përfundoj edhe pse gjatë futjes se të dhënavë në sistem është gabuar emri i shkollës

Procesmbajtësi

Kimete Qorri

Zyrtare e Lartë për Buxhet dhe Financa





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Lista e pjesëmarrësve në DËGJIMIN BUXHETOR në BASHKËSİNË LOKALE TË ARLLATIT; me fshatrat, Arllat, Gjergjicë, Negroc, Llapushnik, Bytyq dhe Vuçak – 30.07.2024

| Nr. | Emri | Mbiemri | Gjinia M F | Nënshkrimi |
|-----|-----------|-----------|------------------|------------------|
| 1. | DERVISH | BYTYQI | M | <i>Derush</i> |
| 2. | HISSEN | GASHI | M | <i>Hisen</i> |
| 3. | URIM | GASHI | M | <i>Urim</i> |
| 4. | BAFTI | GASHI | M | <i>Bafati</i> |
| 5. | XHEVDET | KRASNIQI | M | <i>Xhevdet</i> |
| 6. | VALOET | BYTORI | M | <i>Valoet</i> |
| 7. | BASHKËSIA | GASHI | M | <i>Bashkësia</i> |
| 8. | AVDYL | MTIY | M | <i>Avdyl</i> |
| 9. | FITIM | GASHI | M | <i>Fitim</i> |
| 10. | Arben | Ferizi | M | <i>Arben</i> |
| 11. | Ismajl | Csimoni | M | <i>Ismajl</i> |
| 12. | Taulant | Morina | M | <i>Taulant</i> |
| 13. | Heset | Bujupi | M | <i>Heset</i> |
| 14. | SHUMZIM | BOJUVRI | M | <i>Shumzim</i> |
| 15. | EZERIM | GASHI | M | <i>Ezerim</i> |
| 16. | HYSNI | BUSUPI | M | <i>Hysni</i> |
| 17. | Sahadete | Kitro | F | <i>Sahadete</i> |
| 18. | PETKET | GASHI | M | <i>Petket</i> |
| 19. | Loreto | Thaqi | F | <i>Loreto</i> |
| 20. | Luminje | Krapo | F | <i>Luminje</i> |
| 21. | Kimele | Qori | F | <i>Kimele</i> |
| 22. | Vlorci | Gragci | F | <i>Vlorci</i> |
| 23. | Anitza | Avtulba | F | <i>Anitza</i> |
| 24. | Albulena | Saliuku | F | <i>Albulena</i> |
| 25. | ENDRI | GLLAROVIA | M | <i>Endri</i> |

* Në këtë takim, përvëç kësaj liste, do të bëhen fotografji dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografjtë dhe kjo listë të perdoren për komunikim zyrtar.



| | | | | |
|-----|-----------|-----------------|---|-----------|
| 26. | Nexhmedin | Gruda | M | Hoxhum |
| 27. | Bekim | Dobru | M | Bekim |
| 28. | Muhamed | Gelica | M | Muhamed |
| 29. | KUSHTEM | BAJRAKTARI | M | Kushtem |
| 30. | Antan | Hosni | M | Antan |
| 31. | Valentina | Gashi | F | Valentina |
| 32. | Hysni | Bujqiri | M | Hysni |
| 33. | Ramiz | Lladrovci | M | Ramiz |
| 34. | Djelma | Bektur | F | Djelma |
| 35. | Vlora | Zugoku - Morina | F | Zugoku |
| 36. | Arblind | Mirkuci | F | Arblind |
| 37. | Aurela | Sahiti | F | Aurela |
| 38. | Dolhresa | Berisha | F | Dolhresa |
| 39. | Fuora | KRASNORI | F | Fuora |
| 40. | Eldiaje | Morina | F | Eldiaje |
| 41. | Edar | Talay | F | Edar |
| 42. | Gontiona | Cela | F | Gontiona |
| 43. | Drille | Sykey | F | Drille |
| 44. | Marijan | Qom | F | Marijan |
| 45. | Mimoza | Berisha | F | Mimoza |
| 46. | Arbenita | Rami | F | Arbenita |
| 47. | DRUTA | GJOKA | F | DRUTA |
| 48. | | | | |
| 49. | | | | |
| 50. | | | | |
| 51. | | | | |
| 52. | | | | |
| 53. | | | | |
| 54. | | | | |
| 55. | | | | |
| 56. | | | | |
| 57. | | | | |
| 58. | | | | |
| 59. | | | | |
| 60. | | | | |
| 61. | | | | |



62.

* Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.

